



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 34**

**Datë: 06. 05. 2024; Ora: 13:30**

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Fazli Stollaj, Qemal Kurtis, Mufera Shinik.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

**Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr. 33/2024**
- 2. Raport i Këshillave të KQZ**

#### **3.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i realizimit të planit të punës së KQZ 2024 për tre mujorin e parë (T1)
2. Shqyrtimi dhe miratimi i realizimit të planit të prokurimit 2024 për tre mujorin e parë (T1) "Aktivitetet Zgjedhore"
3. Shqyrtimi dhe miratimi i videospoteve për të rinj dhe ndërrimin e Qendrës së Votimit

#### **3.2. Këshilli për Personel**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të rekrutimit të personelit të përhershëm në KQZ-së 2024
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së zëdhënësit të KQZ-së, lidhur me shtesën për punë pa orar të paracaktuar
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores së Brendshme (KQZ) Nr.12/2024 për Përdorimin e Telefonisë Fikse dhe Mobile
4. Raport i komisionit të ristrukturimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve
5. Raport lidhur me rastet në procedure gjyqësore, ku KQZ është e paditur

#### 4. Të ndryshme

---

##### **Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Në fillim të mbledhjes, kryetari Radoniqi paraqiti agjendën e takimit. Pastaj, ai tha se do ti paraqes dy pika “në të ndryshme” dhe i pyeti anëtarët lidhur me rendin e ditës.

Anëtarët e KQZ-së, nuk patën tjetër, dhe me 10 vota për, miratuan rendin e ditës. Në vazhdim, me 10 vota për, u miratua procesverbali nga mbledhja e fundit: nr. **33/2024**.

### **3. Raport i Këshillave të KQZ**

#### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i realizimit të planit të punës së KQZ 2024 për tre mujorin e parë (T1)

**Arianit Elshani**, tha se KOZ e ka shqyrtuar këtë raport të realizimit të planit të punës së KQZ 2024 për tre mujorin e parë. Madje, edhe dy herë tjera dhe se, janë dhënë komentet për përgatitjen dhe rezultatet e gjetura që janë në faqen e fundit. Përqindja e realizimit të planit të punës janar – mars 2024, është 19.72 %. Janë realizuar 5 aktivitete, dhe në proces plani është në 50 % të realizimit. Përshkrimet, sfidat, mangësitë, realizimi, është pasqyruar në raport përfshirë, edhe votimin në veri.

Elshani, rekomandoi miratimin.

**Alban Krasniqi**, tha se Sekretariati apo institucioni sa më shumë të fokusohet te plani i aktiviteteve sepse, ato janë në fokus të punës së përditshme. Njësitë, duhet të kenë parasysh që në fund të vitit të mos mbeten aktivitete të porealizuara. Gjendja ndryshon, jemi më mirë por jemi gati në përfundim të tremujorit të dytë, dhe në ato aktivitete ku nuk ka progres të arrihet progresi...

Fokus, ti jepet planit të realizimit, veçanërisht prokurimit – tenderimeve sepse, kemi edhe fazën e zgjedhjeve...

Raporti, u miratua me 10 vota për...

2. Shqyrtimi dhe miratohet realizimi – rishikimi i planit të Prokurimit 2024 për tre mujorin e parë (T1) "Aktivitetet Zgjedhore":

**Arianit Elshani**, vazhdoi sërish me pikën e dytë nga KOZ-i. Ai tha se, është shqyrtuar edhe raporti i realizimit të planit të prokurimit 2024 për tre mujorin e parë. Pra, e ka rishikuar! Aktivitetet, kanë qenë në lidhje me proceset në 4 komunat, dhe aktivitetet e tjera. Kemi bërë edhe përgatitjet e ardhshme meqë, dhe ato të planit të punës, si dhe projektet që janë në përgatitje dhe në realizim e sipër. Ai, pasqyroi këto projekte, si dhe aktivitetet e ndryshme.

Këto aktivitete të prokurimit, përcillen me kornizën e realizimit, të prokurimit dhe zbatimit të tyre. Të tjerat, janë pjesë e zakonshme e planit të punës.

Ky plan, tha z. Elshani, konsiderojmë që është konform kapaciteteve tona, detajimeve, procedurave etj. Propozojmë që, ky raport të miratohet.

Në këtë pikë, diskutoi Burim Ahmetaj, që dha shpjegime rreth realizimit të planit të prokurimit - rishikimit të planit.

Me 10 vota për, rishikimit të planit të prokurimit 2024 për tre mujorin e parë.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i videospoteve për të rinj dhe ndërrimin e Qendrës së Votimit:

**Arianit Elshani**, referoi edhe në pikën e tretë të KOZ. Ai, tha se janë shqyrtuar draftet e videospoteve për ndërrimin e qendrës së votimit dhe të projektit për votuesit e rinj në zgjedhje. Ai, pasqyroi projektin e

fundit dhe tha se, projekti është zhvilluar në pothuajse të gjitha shkollat e vendit, por prezenca e nxënësve – të rinjëve ka qenë dukshëm më e vogël për shkak të përfundimit të vitit shkollorë të maturantëve. Ai, rekomandoi që ky projekt të zhvillohet mbase në vjeshtë, në vitin në vijim...

Videospotet, ishin kërkesë e jona. Janë realizuar videospotet, madje edhe për ndërrimin e qendrës së votimit, e që propozoi të shikohet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Me 10 vota për, u miratuan video spotet bashkë me komentet që videospotet të përfshijnë edhe gjuhën turke si pjesë, e realizimit.

Vazhdimi i mbledhjes me dyer të mbyllura...

#### **4. Këshilli për Personel**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të rekrutimit të personelit të përhershëm në

KQZ-së 2024:

**Alban Krasniqi**, në këtë pikë referoi lidhur me planin e Rekrutimit. Është një proces që ka zgjatur, por që kemi parasysh volumin e rekrutimit, pozitiat, shpalljen sa më parë të konkurseve, obligimet ligjore, nevojat e shpalljes së tyre...

Kisha filluar nga pozita e drejtorit të Sekretariatit, pozitë kjo që skadon më 24 shtator. Në bazë edhe të rregullores, së paku 3 muaj para skadimit, pozita duhet me u shpallë, dhe se KQZ jep miratimin që të fillohet aktiviteti.

Janë edhe pozititat e tjera të shqyrtuara në Personel, kërkesat që kanë dalë si më emergjente nga njësitë përkatëse. Tri afate janë paraparë. Në afatin e parë, janë 4 pozita dhe kjo e drejtorit 5 pozita që nuk duhet të vonohen por të shpallen gjatë këtij muaji. Etapa e dytë shpallet gjatë korrikut, dhe pozititat e valës së tretë, fillojnë më 1 gusht.

Në këtë pikë, referoi më gjerësisht zyrtarja e personelit znj. Vahide Behrami. Ajo tha se, është punuar në 3 takime të Këshillit të Personelit për vitin 2024. Paraprakisht, janë miratuar aktet e brendshme të KQZ, dhe Sekretariati ka ndërmarrë veprimet lidhur edhe me planin e rekrutimeve: janë bërë përkrahjet e

vendeve të punës, është bërë ristrukturimi i pozitive në Sekretariat, dhe pastaj është hartuar edhe plani i rekrutimit.

Qendror i Zgjedhjeve me strukturën e re organizative ka paraparë gjithsejtë 108 pozita. Me ligjin e buxhetit për vitin 2024, të buxhetuara janë 93 pozita. Aktualisht, në listë të pagave janë gjithsejtë shtatëdhjetë e katër (74 ) zyrtar përfshirë këtu 11 anëtarët e KQZ-së dhe 63 nëpunës civil.

Pozita të lira gjithsejtë janë tridhjetë e katër (34) prej tyre 19 janë të buxhetuara me ligjin e buxhetit për vitin 2024, ndërsa, 15 pozitat e tjera të lira të parapara me strukturën e re organizative duhet të buxhetohen.

Lidhur me procesin e rekrutimit, janë paraprë 3 faza të rekrutimit. Në bazë të planit të hartuar nga këshilli i personelit, znj. Behrami pasqyro në detaje numrin e pozitive të parapara, planet e rekrutimit për selinë pozitë, mënyrat e zbatimit të konkursit dhe elementet e tjera rekrutuese...

Kryetari **Kreshnik Radoniqi**, tha se është e pamundur që vetëm një person në Personel, ta realizojë, dhe të njëjten çështje, e diskutoi edhe z. **Ilir Gashi**. Në këtë pikë, diskutoi edhe **Alban Krasniqi** tha se, sistemi është i integruar dhe se, procesi është shumë i lehtësuar. Krijohet portfolio, dhe kandidati aplikon me dokumentet e veta. Edhe eksperti, do të asistoj në këtë proces, dhe kemi mbështetje. Procedurat tjera, janë çështje e verifikimit. I kemi nda pozitat, fazat e rekrutimit që do të shpallen hap mbas hapi...Kjo, edhe me e lehtësue punën në personel. Është zyra, është zyrtarja e personelit dhe, e kemi edhe një plan të nevojave prandaj, qysh tani kishim mund me parapa pozita edhe për staf të përkohshëm sepse, i kemi zgjedhjet që presidentja mund ti shpallë në shtator, ta zëmë...

**Arianit Elshani**, tha se e kemi sistemin edhe të mënahximit dhe rekrutimit të resursve njerëzore, administrata e ka. Sfiduese, është edhe çështja e buxhetit për 108 pozitive. Janë dhe 15 pozita të cilat, tani shpresoj shumë që të plotësohen. **Kreshnik Radoniqi**, kërkoi që të punohet edhe në pozitat e stafit të përkohshëm për zgjedhjet e ardhshme...

Duhet ta mbështesim zyrën e personelit, zyrtaren aty, tha z. Elshani.

Me 10 vota për, u miratua plani i rekrutimit të stafit të përhershëm.

**Kreshnik Radoniqi**: Pozita e drejtorit, duhet të shpallet me vendim të veçantë, a po...?

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Hamiti, Kreshnik Radoniqi, Ilir Gashi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, dhe Vaide Behrami.

U vendos që, në kuadër të planit të rekrutimit të vazhdoen përgatitjet për shpalljen e konkurseve sipas etapave të përgatitura, përfshi edhe poztinë e drejtorit të Sekretariatit.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së zëdhënësit të KQZ-së, lidhur me shtesën për punë pa orar të paracaktuar:

**Alban Krasniqi:** Kemi ardhur në përfundim sipas shqyrtimit se, zëdhënësit i takon e drejta në 30% shtesë të pagës. Eksperti juridik, këshilltari po ashtu ka dhënë mendimin e i tij, edhe pse nuk e kemi pasur shumë të qartë. Kemi ardhur me rekomandim që, zëdhënësit të i jepet paga shtesë në 10 %, por që ai, të hartoj raport shtesë lidhur me punën që bën si shtesë... Nuk ka praktika të qarta si matet volumi i punës...

Jemi të hapur ta diskutojmë, këto që thash janë informacione të mbledhura, opinione etj.

**Kreshnik Radoniqi:** Po e jap opinionin tim pse, unë jam kundër. E para, ky vendim nuk ka me u realizue nga Thesari. Vendimi i Avokatit të Popullit për shembull, nuk është realizuar nga Thesari. E kam lexue vendimin e gjykatës Kushtetuese, nenin 27 – është baza jonë për rregullore - për orar të punës shtesë. Zëdhënësi ynë, nuk është i emëruar, nuk është person me mandat. Është person i emëruar, i përzgjedhur... Ai, lexoi nenin 27, dhe pastaj nenin e 2 dhe të 3 dhe shpjegoi se si rregullohet ky problem në Kuvend, Qeveri dhe Presidencë. Këto institucione, e kanë të drejtën për shtesa në orar të paracaktuar...

Kjo, ka të bëjë me politiken, me institucionet politike dhe, jo me ne! Për këto dhe arsye të tjera, unë nuk e votojë këtë kërkesë...

Në këtë pikë, diskutuan “për dhe kundër”: Arianit Elshani, Kreshnik Radoniqi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Alban Krasniqi...

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores së Brendshme (KQZ) Nr.12/2024 për Përdorimin e Telefonisë Fikse dhe Mobile:

**Alban Krasniqi,** e paraqiti edhe këtë pikë e cila, u shqyrtua në detaje. Debati, u zhvillua si diskutuan interaktiv mes anëtarëve të KQZ-së. U shqyrtua kostoja e menaxhimit – përdorimit, lloji i mbushjeve elektronike, shuma e mbushjeve sipas kategorive etj.

Në fund, me 8 vota për, u miratua Rregullorja e Brendshme (KQZ) Nr.12/2024 për Përdorimin e Telefonisë Fikse dhe Mobile.

Në vazhdim të mbledhjes, **Alban Krasniqi**, kryesues i Këshillit për Personel kërkoi mirëkuptim që pika 4 dhe 5 të lihen për mbledhjen e radhës.

4. Raport i komisionit të ristrukturimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

5. Raport lidhur me rastet në procedure gjyqësore, ku KQZ është e paditur

### **5.Të ndryshme!**

**Kreshnik Radoniqi**, tha se është një ftesë nga IFES lidhur me fuqizimin e grave në mbledhje. Takimi, është me Zum.

Herën e parë ka qenë Gjina dhe Megi. Takimi mbahet më 19 qershor...

**Alban Krasniqi**: Le të jetë edhe Emira...

Pika tjetër, tha z. **Radoniqi**, ka të bëj me takimin që ma herët e kam pasur me presidenten lidhur me marrjen e disa zotimeve që vijnë nga takimet me z. Bajden, ndoshta para dy viteve. Kështu që, fjala është për një koncept dokument mbi demokracinë në një samit mbi demokracinë. Janë marrë disa zotime. Për KQZ-në, i kanë ba disa pika... Pra, bashk me ne me hartue një koncept – dokument mbi procesin zgjedhor, edhe në bashkëpunim me partitë politike. Ideja është që ne me caktue dikend...

U propozua Besnik Buzhala, Valmir Elezi... ( nuk dëgjohet qartë...)